

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 205 Prot.

Tiranë, më 13.022017

**VENDIM Nr. 25, datë 09.02.2017**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 2 të datës 09.02.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të projektit "*Ndërtim i ri i ambienteve të punës në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë*", subjekti Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit të terrenit në kuadër të projektit "*Ndërtim i ri i ambienteve të punës në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë*", subjekti Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar i Punësimit, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,
2. Bazuar në *nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar)* nëse zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë. Drejtuesit dhe investitorët e punimeve njoftojnë, brenda tri ditëve, organet e qeverisjes vendore, Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, të cilët bëjnë kontrollin përkatës, raportojnë për vlerat e gjetura dhe bëjnë propozimet përkatëse për vazhdimësinë ose jo të punimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**